РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr________

__________г./v.

ДКСК KSHPK
ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 91-të, të mbajtur më 31.08.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Lënda me numër 12-1906/1 të datës 31.03.2023, **HIDHET POSHT.**

Denoncimi I dorëzuar të dorëzohet për veprim kompetent në PTHP për ndjekje krimit dhe korrupsionit të organizuar.

Lënda me numër 12-1906/1 të datës 31.03.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Lënda me numër 12-1426/1 datë 03.03.2023 është formuar në bazë të denoncimit të dorëzuar nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për shfrytëzimin e pozitës dhe kompetencave zyrtare nga një zyrtar ///, i cili edhe pse e dinte se për tokën në TIRZ Tetovë po zhvillohej procedurë për shpronësim, komisioni për vendosjen e kërkesës. për shpronësimin e rastit në fjalë i "ndaloi" zgjidhjen e rastit. KSHPK-së i kërkohet shqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Krahas kërkesës janë paraqitur edhe dëshmi.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja konstatoi se tashmë kishte vepruar edhe për një tjetër kërkesë për pretendimet e raportuara dhe në seancën e 80-të të mbajtur më 18 janar 2023, miratoi Vendimin nr. 12-524/1 të datës 27 janar 2023 dhe ka dorëzuar iniciativa në Prokurorinë Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Për këtë, KSHPK-ja vendosi që të mos veprojë sipas denoncimit të dorëzuar, dhe me provat e dorëzuara t'ia përcjellë autoritetit të lartpërmendur, duke konsideruar se ndaj të njëjtës tashmë është formuar lëndë me numër ///.

Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska

Доставено до:
- Подносителот
- Основно јавно обвинитлество за гонење на организиран криминал и коруцпија

Изработил: м-р Д. Д.
Одобрил: К. Н.

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk